REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

SENATI AKADEMIK

Nr.4458 Prot. Shkodër, më 18. 11. 2026

VENDIM

Nr.331, datë 18. 11.2026

"Për plotësimin me një anëtar të ri të Komisionit të Apelimit në Universitetin e Shkodrës, si pasojë e vakancës së krijuar me përfundimin para kohe të mandatit të anëtarit të tij''

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 3, pika 4; Statutit të USH-së Neni 5, pika 2, germa *a*; Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në USH", e ndryshuar, neni 37 pika 1 dhe pika 5; Urdhrit Nr.160, datë 12.11.2026 të Rektorit të USH-së "Për hapjen e afatit të aplikimit për plotësimin e vakancave të krijuara për anëtarë të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ) dhe Komisionit Apelimit (KA), nga radhët e personelit akademik me kohë të plotë në USH", Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 18.11.2026,

VENDOSI:

1. Miratimin e zgjedhjes së anëtarit zëvendësues, me mandat plotësues, të Komisionit të Apelimit në Universitetin e Shkodrës, si më poshtë
   a. Zj.Valbona Paja.

2. Mandati plotësues i anëtarit të zgjedhur përfundon me zgjedhjen e Komisionit të ri të Apelimit.

3. Ky vendim i përcillet për njohje Komisionit të Apelimit në USH.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof. dr. Blerta Dragusha